Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/52
Datë: 29.12.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për të Huajt.

2. Obligohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo unutraśnjih poslova / Ministry of Interrnal Affairs

KONCEPT DOKUMENT PËR TË HUAJT

Përgatitur nga Ministria e Punëve të Brendshme

Dhjetor, 2021

PËRMBAJTJA

Përmbledhje e Koncept Dokumentit ... 3
Hyrje ... 5
KAPITULLI 1: PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT ... 7
1.1. Korniza institucionale dhe legjislative e Republikës së Kosovës në fushën e të huajve . 8
1.2. Ndërhyrjet jo-rregullatore (Projektet, ndërtimi i kapaciteteve, fushatat, investimet dhe të ngjashme ... 14
1.3. Problemi kryesor ... 16
KAPITULLI 2: OBJEKTIVAT ... 22
KAPITULLI 3: OPSIONET ... 24
3.1: Opsioni *status quo* (pa asnjë ndryshim) ... 24
3.2: Opsioni i përmirësimit të zbatimit të konrizës aktuale ligjore pa ndryshime legjislative .. 24
3.3: Opsioni i tretë, me ndryshime legjislative ... 25
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme ... 31
4.1. Identifikimi i ndikimeve ekonomike: ... 31
4.2. Identifikimi i ndikimeve shoqërore ... 33
4.3. Identifikimi i ndikimeve mjedisore ... 33
4.4. Ndikimet në të drejtat themelore ... 33
4.5. Vlerësimi i ndikimit gjinor ... 34
4.6. Vlerësimi i ndikimit tek të rinjtë ... 34
4.7. Vlerësimi i ndikimit në grupet e cenueshme ... 34
4.8. Mbrojtja e të dhënave ... 35
4.9. Sfidat me mbledhjen e të dhënave ... 36
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi ... 36
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve ... 38
6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme ... 38
6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet ... 47
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm ... 48
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin ... 48
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik ... 49
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore ... 53
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore ... 58
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore ... 60

Përmbledhje e Koncept Dokumentit

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept dokument për për të Huajt
Ministria bartëse	Përgatitur nga Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim, Divizioni për të Huaj
Personi kontaktues	Kushtrim Haliti Udhëheqës i Qendrës së Mbajtjes 038-200-19-022
PSO	PSO 2021
Prioriteti strategjik	Strategjia për Migrim 2021-2025, Objektivi Specifik 3.5.

Vendimi	
Çështja kryesore	Në bazë të analizës së gjendjes aktuale, problemi mund të përkufizohet në paqartësitë ligjore dhe procedurale, e cila pastaj reflektohet në procedurën e vendimarrjes, përcaktimin e kritereve dhe afateve kohore, definimin e përgjegjësive institucionale, mungesa e mbikëqyrjes dhe kontrollit efikas të zbatimit të ligjit dhe mungesës së statistikave të kompletuara dhe të zbërthyera në masë të kënaqshme.
Përmbledhje e konsultimeve	Konsultimi paraprak për Koncept Dokumentin për të Huajt është zhvilluar në muajin nëntor 2021.
	Konsultimi publik përmes platformës për konsultime publike është zhvilluar gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2021.
Opsioni i propozuar	Opsioni i shqyrtuar dhe i rekomanduar është ndryshimi i kornizës aktuale legjislative, pra **Opsioni 3**. Ky opsion nënkupton hartimin e një ligji të ri, i cili do të rregullonte zbrazëtirat ligjore të hasura përgjatë zbatimit dhe do të rregullonte sfidat e reja të krijuara si rrjedhojë e ndryshimeve të fundit në legjislacionin e Bashkimit Evropian, si dhe do të adresonte problemet e identifikuara gjatë zbatimit.

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Zbatohet në kuadër të kufijve aktual buxhetor.
Ndikimet ekonomike	Si parim, ndikimet ekonomike do të jenë pozitive. Pranimi i të huajve, në veçanti kategoritë me kualifikim të lartë do të ketë ndikim në plotësimin e tregut të punës, respektivisht në sektorët strategjik ekonomik dhe do të ndikoj në mënyrë direkte në zhvillimin ekonomik të vendit. Gjithashtu, integrimi ekonomik i të huajve do të

	ketë ndikim pozitiv në krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë dhe gjithashtu do të ketë ndikim pozitiv në rritjen e tatimeve.
Ndikimet shoqërore	Ligji i ri për të Huajt, përkitazi me integrimin e të huajve do të kenë ndikim të dobishëm shoqëror dhe do të zvogëlojnë mundësitë e ndikimit negativ shoqëror në nivelin lokal për shkak të integrimit efektiv kulturor, për më tepër, krijimi i vendeve të punës për shkak të rritjes së numrit të investimeve të të huajve në ekonominë lokale, do të ketë ndikim në punësueshmërinë më të mirë të grupeve të cenueshme, gjegjësisht të rinjve dhe grave. Në përgjithësi, do të ketë ndikim pozitiv shoqëror.
Ndikimet mjedisore	Në përgjithësi, masat e propozuara nuk do të kenë ndikim mjedisor, me përjashtim të sistemit të menaxhimit të rasteve të aplikimeve për pranimin e të huajve, i cili do të ketë ndikim pozitiv për nga konsumi më i vogël i letrës, ndërsa sistemi i centralizuar do të kontribuojë në uljen e numrit të intervistave me aplikuesit dhe së këndejmi do të ketë më pak udhëtime.
Ndikimet ndër-sektoriale	Masat e propozuara pritet të kenë ndikime ndër-sektoriale duke përfshirë fushën e sigurisë, sundimit të ligjit, tregut të punës, sektorët e ndryshëm ekonomik të vendit.
Ngarkesat ministrative për kompanitë	Në këtë Koncept Dokument është rekomanduar zhvillimi i një strategjie afatgjatë për procesimin e lëndëve bazuar në Tekonologji Informative, duke përfshirë krijimin e e-regjistrit të popullsisë, si dhe evidentimin dhe gjurmimin e të gjitha proceseve për migrim dhe të huaj. Zbatimi i kësaj politike të bazuar në teknologji informative pritet të ketë ndikim në ngarkesën administrative duke ofruar më shumë efikasitet dhe llogaridhënie në shqyrtimin e lëndëve dhe vendimmarrjen përkatëse.
Testi i NVM-së	Marrë parasysh fushën e trajtimit të këtij Konept Dokumenti, realizimi i testit të NVM-së është konsideruar i panevojshëm.

Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	Hartimi i Projektligjit të ri për të Huajt
Afatmesëm	Hartimi i legjislacionit sekondar me ligjin e miratuar. Avancimi dhe ndërlidhja e databazave, si dhe masave që janë paraparë në zbatimin e opsionit të preferuar.

Hyrje

Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për të Huajt
Ministria bartëse	Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion, Divizioni për të Huaj
Personi kontaktues	**Kushtrim Haliti** Udhëheqës i Qendrës së Mbajtjes 038-200-19-022
PSO	PSO për Vitin 2021
Prioriteti strategjik	Strategjia për Migrim 2021-2025, Objektivi Specifik 3.5.
Grupi punues	• Kushtrim Haliti – Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion, Ministria e Punëve të Brendshme – Kryesues; • Meliza Qorraj– Departamenti Ligjor, Ministria e Punëve të Brendshme – zv. Kryesuese; • Gazmend Camaj - Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion, Ministria e Punëve të Brendshme – anëtar; • Qendrim Bytyqi – Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, Ministria e Punëve të Brendshme – anëtar; • Drita Xheladini – Departamenti për Buxhet dhe Financa, Ministria e Punëve të Brendshme – anëtare; • Rroksana Qarri – Zyra për Informim Publik , Ministria e Punëve të Brendshme – anëtare; • Venera Dibra – Njesia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Ministria e Punëve të Brendshme – anëtare; • Marigona Ramaj - Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, Ministria e Punëve të Brendshme – anëtare; • Fitore Metbala – Kabineti i Ministrit, Ministria e Punëve të Brendshme – anëtare; • Rrahman Sylejmani - Policia e Kosovës, anëtar; • Fitim Zariqi - Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion, Ministria e Punëve të Brendshme – anëtar; • Basrie Beka – Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar, Ministria e Punëve të Brendshme – anëtare; • Nehat Pllana – Zyra Ligjore, Zyra e Kryeministrit, anëtar; • Artife Gashi – Sekretariati Koordinues i Qeverisë, Zyra e Kryeministrit, anëtare; • Albert Kurtulaj – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, anëtar; • Semra Mecihan – Ministria e Shëndetësisë, anëtare; • Dardan Nalbani – Ministria e Industrisë, Ndërrmarësisë dhe Tregëtisë, anëtar;

	• Agim Krasniqi – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Tekonoligjisë – anëtar; • Teuta Bllacaku – anëtare, • Përfaqësuesi i Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtar; • Përfaqësues nga Inspektoriati i Punës, anëtar; • Përfaqësues nga Administrata Tatimore e Kosovës, anëtar. Anëtarë të jashtëm: • Drita Perezic – ICITAP; • Isah Maloku – ICITAP; • Bujar Prebeza – UNHCR; • Memli Ymeri – CRPK; • Habib Habibi – IOM • Arife Muji – IOM..
Informata shtesë	Hartimit të koncept dokumentit për të huaj i ka paraprirë vlerësimi i boshllëqeve të përafrimit të legjislacionit vendor me Acquis të BE-së për kapitullin 24.

KAPITULLI 1: PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Koncept Dokumenti për të Huajt synon që të identifikojë mungesat dhe zbrazëtirat në Ligjin ekzistues për të Huajt, si dhe harmonizimin e plotë me direktivat relevante të Bashkimit Evropian.

Ligji aktual për të Huajt Nr. 04/L-219 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 05.09.2013 dhe është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 06/L-036, i publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës me datë 03.05.2018. Me ligjet në fuqi janë transpozuar Direktiva 2014/66/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në suaza të transfereve brenda Korporatave, Direktiva 2014/36/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim të punësimit si punëtor sezonal, Direktiva 2016/801 BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 maj 2016 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta për qëllim hulumtimi, studimi, trajnimi, shërbimi vullnetar, skema të shkëmbimit të nxënësve, apo projekte arsimore, si dhe *au pairing*, si dhe Rregullorja (BE) Nr. 610/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 26 Qershor 2013 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 562/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit që nxjerr Kodin e Bashkësisë mbi rregullat e me të cilat rregullohet lëvizja e personave përtej kufijve (Kodi i Kufijve të Shengenit), Konventa mbi zbatimin e Marrëveshjes së Shengenit, Rregulloret e Këshillit (KE), Nr. 1683/95 dhe (KE) Nr. 539/2001 dhe Rregulloret (KE) Nr. 767/2008 dhe (KE) Nr. 810/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

Identifikimit të problemeve në zbatim të ligjit aktual për të huajt i ka paraprirë një analizë kronologjike e zhvillimeve në fushën e të huajve. Procesi i hartimit të këtij Koncept Dokumenti ka filluar si mënyrë për të adresuar problematikën, si dhe për të përmirësuar kornizën e legjislacionit vendor në fushën e të huajve. Ky koncept dokument përveç që është pjesë e politikave strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës (Strategjia për Migrim 2021-2025), gjithashtu lidhet edhe zbatimin e Acquis-it të BE-së, konkretisht me kapitullin 24, respektivisht me fushën që lidhet me migrimin, siç është konstatuar edhe në vlerësimin e boshllëqeve të përgatitur nga Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 2020.

Legjislacioni i BE-së i cili duhet më tej të transpozohet në Ligjin për të Huajt dhe në aktet nënligjore janë si në vijim:

- Direktiva e Këshillit Nr. 2003/86/KEe 22 shtatorit 2003 për të drejtën e ribashkimit të familjes; Direktiva e Këshillit 2003/109/KE e 25 nëntorit 2003 lidhur me statusin e shtetasve të shteteve të treta të cilët janë banorë afatgjatë;
- Direktiva e Këshillit 2009/50/KE e 25 majit 2009 për kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të shteteve të treta me qëllim të punësimit si punëtorë me kualifikim të lartë (Direktiva Kartela e Kaltër e BE- së);
- Direktiva 2011/98/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 13 dhjetorit 2011 për procedurë të vetme të aplikimit për leje të vetme për shtetasit e shteteve të treta për të qëndruar dhe punuar në territorin e një Shteti Anëtar dhe për një grup të përbashkët të të drejtave për punëtorët e shteteve të treta që banojnë legalisht në një Shtet Anëtar;
- Direktiva 2014/36/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 26 shkurtit 2014 për kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të shteteve të treta, me qëllim të punësimit si punëtorë sezonal;

- Direktiva 2014/66/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 15 majit 2014 për kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të shteteve të treta në kuadrin e transferimit brenda korporatave;
- Direktiva (BE) 2016/801 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 majit 2016 për kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të shteteve të treta për qëllime kërkimi, studime, trajnime, shërbim vullnetar, skema shkëmbimi të nxënësve ose projekte arsimore, dhe vendosje në familje;
- Draft Rregullorja e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit që ndryshon Rregulloren (KE) Nr 862/2007 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për Statistikat e Komunitetit për Migrim dhe Mbrojtjen Ndërkombëtare.

Në kuadër të këtij koncept dokumenti do të analizohen mangësitë në fushën e të huajve, duke u nisur nga boshllëqet dhe paqartësitë ligjore, mungesës së mbikëqyrjes efektive të zbatimit të ligjit, përcaktimit të afateve kohore në zbatim të procedurave, paqartësitë në vendimmarje nga institucionet dhe akterët e ndryshëm. Për të gjitha këto çështje janë rekomanduar masat për adresimin e tyre në një periudhë 3-5 vjeçare.

1.1. Korniza institucionale dhe legjislative e Republikës së Kosovës në fushën e të huajve

Gjatë përgatitjes së këtij Koncept Dokumenti, Ministria Punëve të Brendshme ka marrë parasysh një numër të instrumenteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me fushën e të huajve. Domeni ligjor që rregullon statusin e të huajve në lidhje me hyrjen, qëndrimin dhe daljen e tyre nga Kosovë është një fushë komplekse që aderon në fushën e Ligjit për të Huajt, ajo udhëhiqet dhe rregullohet nga parimet e përfshira në Kushtetutën e Kosovës, e cila në nenin 35 përcakton që hyrja dhe qëndrimi i të huajve rregullohet me ligj. Për më tepër, Kushtetuta përcakton vlerat, ndër të cilat sundimi i ligjit dhe respektimi i të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimi janë vlera kryesore me rëndësi edhe për çështjet që lidhen me të huajt. Të drejtat dhe liritë themelore, siç përcaktohet nga konventat dhe instrumentet thelbësore të së drejtës ndërkombëtare të parashikuara në Nenin 22 të Kushtetutës, janë garanci se shteti pranon një detyrim për të mbrojtur statusin dhe të drejtat e të huajve edhe me aplikueshmërinë e tyre të drejtpërdrejtë në rast të shkeljes së Ligjit për të Huajt ose ligjeve tjera që ndikojnë në vendimet për statusin e një të huaji. Këto traktate janë:

1. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut.
2. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe Protokolet e saj.
3. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollet e tij.
4. Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare.
5. Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor.
6. Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave.
7. Konventa për të Drejtat e Fëmijës.
8. Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve dhe Ndëshkimeve tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.
9. Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës Kundër Grave dhe Dhunës në Familje.

Aplikimi i ligjit të traktateve ndërkombëtare parashikon gjithashtu ndikimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut si burim i rëndësishëm i së drejtës zakonore ndërkombëtare për institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrinë e Punëve të Brendshme, dhe kur është e përshtatshme, gjithashtu gjyqësori i Republikës së Kosovës, në veçanti në rast të shkeljes së të drejtave themelore dhe të njeriut, siç garantohet nga ligji ndërkombëtar i traktateve i përmendur posaçërisht edhe në Kushtetutën e Kosovës si akti i saj më i lartë juridik.

Korrelacioni i garancive procedurale të kushtetutës që kanë ndikim edhe në fushën e kornizës ligjore mbi të huajt, është i rëndësishëm për nenin 32 - e drejta për mjet juridik gjithashtu kundër vendimeve administrative dhe nenin 36 - E drejta për privatësi duke përfshirë jetën familjare dhe mbrojtjen e të dhënave, si dhe nenin 41 e drejta e qasjes në dokumente publike.

Në kuptim të strukturës institucionale, institucionet kryesore vijuese janë përgjegjëse për zbatimin e dispozitave ligjore siç përcaktohet në Ligjin aktual për të Huaj:

- Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim;
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Policia e Kosovës;
- Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës.

Secili institucion zbatues i ligjit ka përgjegjësinë e tij në fushën e vet, si vijon:

Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim, konkretisht Divizioni për të Huajt është përgjegjës për shqyrtim dhe vendosje për leje të qëndrimit për personat e huaj dhe ata pa shtetësi.

Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës është përgjegjëse për shkqyrtim dhe vendosje në kërkesat për pajisje me viza për shtetasit e huaj.

Policia e Kosovës, Policia Kufitare përmes njësive të veta organizative ka në mandatin e saj kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror në pikat e kalimit kufitar dhe brezin e gjelbër, kontrollin dhe mbikëqyrjen e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të huaj në Kosovë, largimin dhe depërtimin e shtetasve të huaj me qëndrim të paligjshëm nga territori i Republikës së Kosovës, si dhe ndalimin e hyrjes së tyre kur plotësohen kushtet ligjore, si dhe bashkëpunon ngushtë me Divizionin për të Huajt, si dhe MPJD-në për verifikim të aplikimeve për hyrje dhe qëndrim në territorin e Republikës së Kosovës.

Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, e cila funksionon në kuadërt të Ministrisë për Financa, Punë dhe Transfere e që është përgjegjës për lëshimin e lejeve afatshkurtër të punës për të huaj, me kohëzgjatje prej 30 ditëve, 60 ditëve dhe 90 ditëve, brenda një periudhe kohore prej 180 ditëve, gjatë një (1) viti.

Korniza e përgjithshme legjislative paraqet kështu një grup të fuqishëm të parimeve dhe rregullave, të zhvendosura kryesisht nga korniza legjislative e BE-së për migracionin që kërkon një nivel të lartë të njohurive të disiplinave të ndryshme të ligjit, dhe për këtë qëllim kërkon nga stafi i angazhuar në procesin e vendimmarrjes dhe formulimit të politikave të ndryshme nivel të lartë të përvojës praktike në aspektet e ndjeshme në lidhje me statusin e të huajve nën garancitë, gjithashtu i përcaktuar si obligime të detyrueshme që rrjedhin nga e drejta ndërkombëtare.

Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare	Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim	Roli dhe detyrat e Institucionit (-eve)
Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876	Ministria e Punëve të Brendshme	Rregullon kushtet e hyrjes, lëvizjes, qëndrimit dhe punësimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës.
Ligji Nr. 06/L –036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të Huaj	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8876	Ministria e Punëve të Brendshme	Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt.
Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 04/2020 për Refuzimin e Hyrjes në Republikën e Kosovës	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=30997	Ministria e Punëve të Brendshme	Rregullon modalitetin për refuzimin e hyrjes në Republikën e Kosovës, të huajve që nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në Ligjin për të Huajt.
Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 09/2019 për Procedurën dhe Kriteret	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=23314	Ministria e Punëve të Brendshme	Rregullon procedurën dhe kriteret për aplikimin, lëshimin, refuzimin dhe

për Lëshimin e Lejeve të Qëndrimit për të Huajt			revokimin e lejes së qëndrimit për të huajt, lejen e qëndrimit të përkohshëm për të huajt, qëndrimin e përhershëm dhe formën dhe përmbajtjen e lejes së qëndrimit për të huajt.
Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 09/2019 për procedurën e lëshimit të lejes së qëndrimit për të huajt dhe vërtetimit për lajmërimin e punës	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=23314	Ministria e Punëve të Brendshme	Rregullon procedurën dhe kriteret e aplikimit, lëshimit, refuzimit dhe revokimit të lejeqëndrimit për të huajt, lejen e punës afatshkurtër për të huajt, lejen e qëndrimit të përkohshëm, përhershëm, si dhe formën dhe përmbajtjen e lejeqëndrimit për të huajt.
Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 02/2014 për Dokumentet e Udhëtimit për të Huaj	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9842	Ministria e Punëve të Brendshme	Përcakton procedurat për lëshimin, formën dhe përmbajtjen e dokumenteve të udhëtimit për të huajt.
Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 08/2014 për	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=35940	Ministria e Punëve të Brendshme	Përcakton kushtet dhe procedurat për lëshimin e

Kushtet dhe Procedurat për Lëshimin e Vizave në Pikat e Kalimit të Kufirit			vizave në pikat e kalimit kufitar nga Policia Kufitare.
Udhëzimi Administrativ (MPB) Nr. 09/2020 për Kushtet dhe Procedurat e Zgjatjes së Vizave	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=35835	Ministria e Punëve të Brendshme	Përcakton kushtet dhe procedurat për zgjatjen e vizës.
Udhëzimi Administrativ MPJ/Nr. 01/2014 për Procedurat e Lëshimit të Vizave për të Huajt nga Misionet Diplomatike dhe Konsullore të Republikës së Kosovës	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10166	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	Përcakton dhe rregullon procedurat dhe kushtet për lëshimin e vizave për të huajt nga Misionet Diplomatike dhe Konsullore ose organet e autorizuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, për qytetarët e shteteve të cilave Republika e Kosovës aplikon regjim të vizave.

Rregullorja (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=21006	Ministria e Punëve të Brendshme	Përcakton procedurat, kriteret dhe institucionet përgjegjëse për integrimin e të huajve në jetën sociale, ekonomike dhe kulturore në Republikën e Kosovës.
LIGJI Nr. 05/L -020 për barazi gjinore	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10923	ZKM	Ky ligj, garanton, mbron dhe promovon barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.

1.2. Ndërhyrjet jo-rregullatore (Projektet, ndërtimi i kapaciteteve, fushatat, investimet dhe të ngjashme)

Sa i përket ndërtimit të kapaciteteve dhe projekteve të asistencës teknike, nga pavarësia e vendit e tutje, kishte projekte të ndryshme lidhur me migrimin që synonin kryesisht të kontribuonin në kapacitetet e Ministrisë së Punëve të Brendshme, konkretisht DSHAM, për të transferuar njohuritë që një shtetit të ri i duhen për t'i menaxhuar sfidat lidhur me migrimin nën mandatin e saj.

Shifrat në lidhje me trendet e përgjithshme për migrim, të marra nga Profili i Lehtë i Migrimit 2019, Profili i Zgjeruar i Migrimit, Draft-Strategjia e Migracionit 2019-2023 dhe Raporti i Progresit i KE për Kosovën i 6 tetorit 2020, demonstrojnë nevojat e ndërhyrjeve dhe fushatave kryesisht në fushën e lëvizjes së parregullt.

Përveç projektit të binjakëzimit të nisur në 2010-2012, për Forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë, të financuar nga BE dhe implementuar nga Austria, i cili siguroi parimet themelore për menaxhimin e migracionit në përgjithësi, ka pasur edhe projekte tjera që synojnë fuqizimin e kapaciteteve në menaxhimit të migracionit. Një nga projektet e tilla ishte Forcimi i Autoriteteve të Menaxhimit të Migrimit në Kosovë (MIMAK)[1]-2017-2021, që synonte forcimin e punës së Koordinatorit Kombëtar për Migrim dhe të Autoritetit Qeveritar për Migrim (AQM), duke përkrahur ristrukturimin e strukturave të menaxhimit të migracionit në Kosovë, duke lehtësuar mbledhjen dhe analizat e përmirësuara të të dhënave, trajnimin e anëtarëve të AQM dhe përkrahjen e zyrtarëve qeveritarë në publik duke synuar përmirësimin e informatave për migrim. Projekti gjithashtu kontribuoi në krijimin e profilit të zgjeruar të migrimit të Kosovës dhe profileve të lehta të migrimit në baza vjetore. Projekti u financua nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Migrim përmes Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran në Kosovë dhe u implementua nga ICMPD në partneritet me Universitetin e Mastrihtit.

Në këtë drejtim, drafti i Strategjisë së Migrimit Shtetëror 2019-2023 i Kosovës nënvizon përkrahjen e vazhdueshme të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim në marrëveshjen kornizë të partneritetit për migracionin ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës, që ofron mundësi për trajnime, fushata tematike rreth rregullave të vizave në zonën Shengen, rreth pasojave të migrimit të parregullt.

Një projekt tjetër i financuar nga BE dhe i implementuar nga Shërbimi i Imigracionit dhe Natyralizimit të Ministrisë së Sigurisë dhe Drejtësisë së Holandës, në partneritet me Agjencinë Suedeze të Migracionit dhe Ministrinë Federale të Brendshme të Austrisë është projekti 'Forcimi i institucioneve të Kosovës në menaxhimin efektiv të migracionit (Projekti i Binjakëzimit)'. Objektivi i përgjithshëm i këtij Projekti të Binjakëzimit ishte rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhimin e migracionit në përputhje me praktikat më të mira të acquis të BE-së dhe prioritetet e përgjithshme të zhvillimit të Kosovës. Si dhe për ta forcuar kapacitetin e institucioneve ekzistuese dhe për ta siguruar harmonizimin me standardet e BE-së në menaxhimin e migrimit dhe azilit. Ky projekt filloi në 1 mars 2016 dhe përfundoi në 28 shkurt 2019.

Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) përmes GIZ është aktive në Kosovë përmes 'Programit të Migrimit dhe Zhvillimit'. Ky program, ndër të tjera, i përkrahë institucionet e Kosovës në forcimin e strukturave të qeverisjes së migracionit brenda shtetit. Një

[1] https://www.icmpd.org/news-centre/news-detail/project-news-launching-of-the-main-phase-of-mimak/

numër i masave dhe trajnimeve për ndërtimin e kapaciteteve janë zhvilluar për Autoritetin Qeveritar për Migrim, si dhe për akterët institucional të synuar.

Duke pasur parasysh faktin se lëvizja e parregullt e qytetarëve të Kosovës në shtetet në zonën Shengen paraqet sfidë për autoritetet e migrimit/riintegrimit të Kosovës që nga pavarësia e tutje (dhe para saj), kthimi dhe riintegrimi ende ka prioritet të lartë për autoritetet e migrimit të Kosovës. Përveç migrantëve të parregullt nga Kosova të cilët qëndrojnë në kundërshtim me normat e aplikueshme të ligjit të migrimit në zonën Shengen dhe BE, Kosova është gjithashtu territor transit për lëvizjet e parregullta të të huajve që po kalojnë transit nëpër territorin e Kosovës si pjesë e rrugës së Ballkanit Perëndimor, e cila mundëson kalimin transit nga Rruga Mesdhetare Lindore drejt BE-së. Raporti i përbashkët i Europol, Frontex dhe EASO, "Trajtimi i Kontrabandës me Migrantë në Ballkanin Perëndimor (2018-2019)", tregon qartë se organizimi i kontrabandës së migrantëve është ende biznes fitimprurës për krimin e organizuar ndërkombëtar. Për këtë qëllim, autoritetet e migrimit të Kosovës me zbatuesit e ligjit, marrin pjesë në luftën kundër kësaj forme të krimit të organizuar ndërkombëtar.

Projektet me transferim të njohurive që synojnë të forcojnë kapacitetet e shtetit për të qenë të suksesshëm në tejkalimin e sfidave në lidhje me migrimin e parregullt, janë një nga masat që kontribuojnë në kapacitetin e përgjithshëm në menaxhimin e migrimit.

Agjencia Austriake për Integrim Evropian dhe Zhvillim Ekonomik në bashkëpunim me BE ka kontribuar edhe në Projektin për Forcimin e Ripranimit dhe Riintegrimit në Kosovë në mes 2013 dhe 2015[2] me objektiv të përkrahjes së menaxhimit të integruar të kufirit dhe implementimin e ripranimit duke e harmonizuar atë me Acquis të BE-së, projekt që synoi edhe lehtësimin e riintegrimit të qëndrueshëm të të kthyerve në Kosovë, duke përfshirë forcimin e kapaciteteve administrative dhe institucionale të institucioneve përkatëse.

Impakt pozitiv në riintegrimin e përgjithshëm të të kthyerve në Kosovë luan programi shumëvjeçar i BE-IOM për kthim dhe riintegrim[3] bazuar në partneritetin afatgjatë në mes të IOM-it, zyrës së BE-së në Kosovë dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim që ndihmon të kthyerit të integrohen në shoqërinë kosovare. Aktualisht, është në vazhdim faza V e lansuar në nëntor 2017 me kohëzgjatje prej 42 muajsh. Në kontekstin e ripranimit dhe riintegrimit, duhet të theksohet kontributi i programit të IOM-it të kthimit vullnetar të asistuar dhe riintegrimit vullnetar[4] (AVRR).

Sidoqoftë, Ministria e Punëve të Brendshme dhe IOM kanë nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi në lidhje me bashkëpunimin në programin e kthimit vullnetar të asistuar dhe riintegrimit vullnetar në 2019, duke synuar të huajt me status të parregullt në Kosovë dhe të cilët janë subjekt i kthimit në shtetin e tyre të origjinës.

Duke pasur parasysh faktin që për periudhën 2019-2020 Kosova realizoi një rol të rëndësishëm si Presidencë[5] e proceseve rajonale për migrim nën MARRI RC në Shkup, pra e vetmja organizatë rajonale ndërqeveritare e krijuar për bashkëpunim në Ballkanin Perëndimor, është e rëndësishme të theksohen prioritetet për këtë vit: Bashkëpunimi i integruar i menaxhimit të kufirit,

[2] https://www.aei.at/strengthening-readmission-and-sustainable-reintegration-in-kosovo-kos-ii/?lang=en
[3] http://kosovo.iom.int/eu-return-reintegration-kosovo
[4] https://kosovo.iom.int/assisted-voluntary-return-and-reintegration-programmes
[5] http://marri-rc.org.mk/wp-content/uploads/2019/08/Priorities-of-Kosovo-Presidency-in-Office.pdf

bashkëpunimi në luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe kontrabandimin me migrantë, harmonizimi i standardeve rajonale të azilit, implementimi i marrëveshjeve për ripranim. Në këtë rol, Kosova gjithashtu e përkrahu implementimin e projektit rajonal "Parandalimi dhe Luftimi i TQNj në Ballkanin Perëndimor", implementuar nga GIZ.

1.3. Problemi kryesor

Në Republikën e Kosovës, sidomos në trendet e viteve të fundit, vërehet një numër i madh i personave të huaj të cilët kanë qëndrim të ligjshëm në Republikën e Kosovës për arsye të ndryshme, si bie fjala, jetojnë, studiojnë apo edhe për qëllime turistike. Qëndrimi i tyre në Republikën e Kosovës është i shoqëruar me aktivitete të ndryshme që gjejnë rregullim ligjor, e që nënkupton se Ligji për të Huajt duhet të jetë i atillë sa të adresojë situatat e ndryshme që shfaqen në praktikë. Ligji për të Huajt për nga objekti i marrëdhënieve juridikoshoqërore që rregullon, është element dhe tregues i një impakti afatgjatë për zhvillimet ekonomiko-shoqërore në territorin e Republikës së Kosovës.

Është një mendim përgjithësisht i ndarë nga hisedarët relevant kyç se Ligji nr. 04/L-219 për të Huajt dhe Ligji Nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt konsiderohet të jetë në harmonizim të plotë ose të avancuar me *acquis* të BE-së për migrim të ligjshëm, përkatësisht rreth 33% e legjislacionit vendor është harmonizuar plotësisht me Acquis të BE-së kurse 77% ka harmonizim të avancuar me Acquis të BE-së për migrim të ligjshëm. Në mënyrë që Ligji, por edhe aktet nënligjore që burojnë prej tij të jenë në përputhshmëri edhe më të lartë me *acqui* të BE-së, kërkohet që të jenë në përputhje me disa elemente të Direktivës së Këshillit 2003/86/EC të 22 Shtatorit 2003 për të drejtën e bashkimit familjar (FRD) si: masa mbrojtëse procedurale, viza hyrëse për anëtarët e familjes, të cilëve u jepet leja e qëndrimit e bashkimit të përkohshëm familjar. E njëjta gjë vlen për pajtueshmërinë e tyre me Direktivën e Këshillit 2003/109/EC të 25 nëntorit 2003 në lidhje me statusin e shtetasve të shteteve të treta që janë banorë afatgjatë (LTRD), përkatësisht elementet si: masat mbrojtëse procedurale, validiteti i letërnjoftimit të qëndrimit të përhershëm, rregullat për trajtimet e barabarta, duhet të transpozohen në legjislacionin vendor[6]. Rrjedhimisht, ky koncept dokument erdhi pas identifikimit të nevojës për përmirësim të vazhdueshëm të kornizës së politikave të migrimit të ligjshëm në vend, duke përafruar me tej legjislacionin për migrim me *acquis* të BE-së dhe konventat ndërkombëtare në kuadër të procesit të integrimit në BE, si dhe miratimi paralelisht i normave ndërkombëtare në këtë fushë.

Një nga çështjet e identifikuara gjatë analizës së bërë, ka të bëjë me paqartësinë ligjore në Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt, përkatësisht në mes të nenit 6 dhe nenit 59, pika 1.3. Akterët relevant kanë identifikuar nevojën për procedurë të hollësishme për implementimin e këtyre dy dispozitave të ligjit të cilat në fazën aktuale janë të paqarta. Një paqartësi e tillë u konfirmua edhe nga raporti i Komisioni Parlamentar i Hetimit, i krijuar *ad-hoc* për hetimin e revokimit të lejeve të qëndrimit dhe dëbimit të gjashtë (6) shtetasve turq më 29 mars 2018. Problemi sipas këtij raporti shfaqet sidomos tek revokimi i lejeve të qëndrimit.

[6] Referojuni vlerësimit nga LAGA për migrim të ligjshëm për detaje të mëtejshme.

Disa prej shkeljeve të identifikuara, kanë rezultuar të paktën pjesërisht prej mangësive në ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Prandaj, Komisioni ka rekomanduar ndër të tjera që:

- Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji Nr. 04/L-219 për të Huajt, në mënyrë që të ndalojë dëbimin ose ekstradimin e të huajve në vendet ku ata mund t'i nënshtrohen torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese, në përputhje me parimin e së drejtës ndërkombëtare, non-refoulement.
- Të krijojë një mekanizëm institucional, ose të ngarkojë një institucion ekzistues, me përgjegjësinë për të vlerësuar nëse të huajt, me rastin e dëbimit ose ekstradimit në një vend të caktuar, mund t'i nënshtrohen torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese, në atë vend.
- Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji Nr. 04/L-219 për të Huajt, në mënyrë që të obligohet Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migrim, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për t'iu komunikuar të huajve bazat faktike për vendimet për revokimin ose refuzimin e lejeqëndrimeve, pa përjashtim.
- Të ndryshohet dhe plotësohet Ligji Nr. 04/L-219 për të Huajt, në mënyrë që të ndalohet dëbimi i të huajve përpara se të ushtrojnë të drejtën e tyre për t'u ankuar kundër dëbimit të vet, tek një autoritet i pavarur.

Për më tepër, situata e krijuar me paqartësitë ligjore dhe autorizimit për revokim kur konsiderohet se është cenuar siguria kombëtare, shfaq edhe problematikat në vijim:

- Kosova në mënyrë të njëanshme deklaroi në Kushtetutën e saj se obligohet me marrëveshjet dhe traktatet ndërkombëtare, ndër të tjera edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) me protokolet e saj, si dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR), si dhe Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimeve dhe Ndëshkimeve tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (CAT): të gjitha instrumentet kanë ndikim të natyrës detyruese për vendimet që mund të kenë pasoja serioze për jetën e personit në fjalë në rast se nuk aplikohen garancitë procedurale.

- CAT, neni 3, përcakton një parim të përgjithshëm të moskthimit të një të huaji në shtetin e origjinës, e njëjta normë është e parashikuar në KEDNJ, neni 3 (Ndalimi i torturës: Askush nuk i nënshtrohet torturave ose trajtimeve çnjerëzore ose ndëshkimeve degraduese), ndërsa neni 13 i ICCPR *përcakton se* "një i huaj i ligjshëm në territorin e një Shteti Palë në këtë Pakt, mund të dëbohet vetëm në zbatim të një vendimi të marrë në përputhje me ligjin dhe me përjashtim të rasteve, kur kjo kërkohet për arsye tjera të sigurisë kombëtare, lejohet parashtrimi i arsyeve kundër dëbimit të tij dhe që lënda e tij të rishqyrtohet dhe të përfaqësohet para një autoriteti kompetent ose personit apo personave të caktuar posaçërisht nga autoriteti kompetent.

Një paqartësi ligjore vërehet në mes të Ligjit Nr. 04/L-219 për të Huajt (për integrimin e të huajve në jetën ekonomike, shoqërore dhe kulturore) dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve. Ekziston një kuptim i përbashkët se ky problem duhet të adresohet ashtu që kompetencat të qartësohen.

Sfidë tjetër është edhe mungesa e implementimit adekuat të legjislacionit për të huajt. Këto sfida lidhen kryesisht me bashkëpunimin dhe koordinimin e pamjaftueshëm ndërinstitucional,

mungesën e ndërveprimit dhe ndërlidhjen ndërmjet bazave të të dhënave të ndryshme dhe sistemeve të Teknologji Informative, kompetencat e paqarta në drejtim të vendimmarrjes.

Për më tepër, si problematikë është identifikuar edhe afati tridhjetë (30) ditor për shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve për aplikim për leje qëndrimi, sepse është vlerësuar se ky afat është tepër i shkurtër në raport me rëndësinë dhe kompleksitetin që mund të kenë lëndët, andaj edhe është vlerësuar nevoja e zgjatjes së afatit.

Tutje, ndërveprimi i bazave të të dhënave dhe sistemeve të Tekonologjisë Informative në lidhje me hyrjen dhe qëndrimin e të huajve mbetet ndër sfidat kryesore për implementimin e legjislacionit për të huajt. Është identifikuar që Sistemi Informativ i Vizave i Kosovës (SIVK) nuk ndërlidhet automatikisht me bazën e të dhënave për të huajt në DSHAM. Mangësi të ngjashme raportohen në lidhje me ndërlidhjen në mes të bazës së të dhënave të DSHAM dhe bazave të të dhënave tjera si ato nga Policia e Kosovës, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë, Agjencioni i Regjistrimit Civil etj.

MPB, konkretisht DSHAM është përgjegjëse për lëshimin e lejeve të qëndrimit për të gjitha kategoritë, përfshirë edhe për qëllime punësimi në mungesë të 'kuotës vjetore të punësimit për të huajt'. Edhe nëse 'kuota vjetore e punësimit' nuk miratohet nga Qeveria, APRK duhet ta ketë një konfirmim final për aplikacionet për leje punësimi bazuar në analizën e tregut të punës dhe kërkesën për forcë punëtore të huaj. E njëjta gjë vlen për institucionet tjera siç është Ministria e Tregtisë dhe Industrisë kur i huaji aplikon për leje qëndrimi bazuar në biznesin e hapur në Kosovë, ose me Ministrinë e Arsimit përsa i përket regjistrimit të studentëve të huaj në universitetet në Kosovë.

Gjithashtu, është vlerësuar se ka një paqartësi tek mënyra e rregullimit të lejeve të punës në raport me lejeqëndrimet me qëllim pune.

Një tjetër problem i identifikuar është ai i përgjegjësive të mbivendosura në mes të institucioneve në vendimmarrje, e që paraqesin vështirësi në gjenerimin e statistikave të sakta. Shembull konkret është procedura kur merren vendime për largim me forcë. Për momentin, marrja e vendimeve për largim me forcë bëhet nga dy (2) organe që marrin vendime të tilla. Në përputhje me kornizën aktuale ligjore është kompetencë e DSHAM brenda MPB, që të marrë një vendim të tillë në rastet e kthimit të të huajve të cilëve iu është revokuar leja e qëndrimit, ndërsa në anën tjetër Drejtoria për Migrim dhe të Huaj brenda Policisë së Kosovës është përgjegjëse të marrë vendim për largim me forcë në rastet e të huajve që gjenden me qëndrim të paligjshëm në territorin e Republikës së Kosovës. Një ndarje e tillë e kompetencës ka paraqitur probleme të vazhdueshme në praktikë andaj edhe është identifikuar si një ndër arsyet pse ligji aktual ka vështirësi në zbatim adekuat.

Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	Ndikimi tek sektori privat që punëson të huaj, sidomos ata me kualifikime të larta dhe të kërkuar nga tregu i punës.
	Cenim i të drejtave të të huajve.

	Cenim i sigurisë publike dhe nacionale.
Problemi kryesor	Paqartësitë rreth procedurave të vendimmarrjes, përcaktimin e kritereve dhe afateve kohore, kompetencat, mbikëqyrja jo efektive e zbatimit të ligjit në terren, mungesa e statistikave të kompletuara, koordinimi i dobët ndër-institucional.
Shkaqet	Mungesa e ndërlidhjeve automatike të sistemeve për shkëmbim të të dhënave për fushën që lidhet me hyrjen dhe qëndrimin e të huajve në Republikën e Kosovës.
	Neni 6 dhe Neni 59 definon çështjen por nuk rregullon procedurën.
	Kohëzgjatja e lejeqëndrimeve për kategori të caktuara.
	Paqartësitë lidhur me kuotën vjetore të punësimit sipas Dispozitave të Nenit 69 dhe 70 të Ligjit për të Huaj.
	Mungesa e masave ndëshkimore nga ana e Inspektoratit të Punës ndaj bizneseve të cilat punësojnë të huajt me qëndrim të paligjshëm në Kosovë.

Figura 4: Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	Shkaku-qet dhe/ose efekti (efektet) me të cilat është e lidhur pala	Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet).
Departamenti për Shtetësi, Azil dhe Migracion	Cenim i të drejtave të të huajve Cenim i sigurisë publike dhe nacionale	Divizioni për të Huaj është përgjegjës për shqyrtimin dhe vendimmarrjen rreth kërkesave për lejeqëndrim, si dhe për revokimin e lejeve të qëndrimit për të huaj. Paqartësitë procedurale në rastet e revokimit të lejeve të qëndrimit për të huaj, si dhe koordinimi jo i kënaqshëm në rastet e vendimmarjes për lëshimin e lejeve të qëndrimit për kategori të ndryshme për të huaj. Kjo situatë ndikon në integritetin dhe besueshmërinë e procesit rrjedhimisht edhe në vet Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion si organ kompetent, përgjegjës për zbatimin e legjislacionit në fushën për të huaj.
Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (DMH), Policia e Kosovës	Cenim i të drejtave të të huajve Cenim i sigurisë publike dhe nacionale	Drejtoria për Migrim dhe të Huaj brenda Policisë së Kosovës është përgjegjëse për kontrollin dhe mbikëqyrjen e të huajve me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Kosovës, lëshimin e vendimit për largim të detyruar dhe largimin e të huajve. Me legjislacionin aktual, DMH lëshon urdhërlargim me forcë për të huajt me qëndrim të parregullt në territorin e Kosovës, përderisa DSHAM lëshon vendim për largim në rastet e revokimit dhe refuzimit të lejeqëndrimit të

		një të huaji për arsye të ndryshme. Kjo shkakton paqartësi procedurale dhe përzierje të kompetencave, si dhe ndikon në mungesën e një sistemi të harmonizuar për gjenerimin e statistikave për këto kategori.
Agjencia për Punësim e Republikës së Kosovës (APBK)	Mungesa e kompetencave dhe vendimmarjes në rastet e lëshimit të lejeve të qëndrimit për të huaj	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Agjencia për Punësim e Republikës së Kosovës, janë përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikave të punësimit në Republikën e Kosovës, duke përfshirë edhe punësimin e të huajve. Në legjislacionin aktual për të huaj, kompetencat e APRK-së në shqyrtimin e kërkesave për leje-qëndrim për qëllime punësimi është e kufizuar, në lëshimin e lejeve afat-shkurtër të punësimit. Duke pas parasysh se edhe në mungesë të një vendimi të Qeverisë për përcaktimin e 'kuotës vjetore' për punësimin e të huajve në Republikën e Kosovës, vendimi për lëshimimin e kësaj kategorie të leje-qëndrimit duhet të bazohet në analizat e tregut të punës të cilat bëhen nga APRK. Kjo për qëllim të hartimit të politikave për punësimin e të hujave bazuar në nevojat e tregut të punës dhe që do të kontribuonin në zhvillimin ekonomik të vendit. Gjithashtu është vlerësuar se ka një paqartësi tek mënyra e rregullimit të lejeve të punës në raport me lejeqëndrimet me qëllim pune.

KAPITULLI 2: OBJEKTIVAT

Qëllimi kryesor përkufizohet në zbatimin e obligimeve që dalin nga Marrëveshja për Stabilizim dhe Asociim mes Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës, respektivisht në dispozitat e kësaj marrëvshje që ndërlidhen me harmonizimin e legjislacionit vendor më atë të BE-së në fushën e migrimit. Ky qëllim është i reflektuar edhe në Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Ndërsa, sa i përket objektivit strategjik, me këtë Koncept Dokument synohet harmonizimi i mëtutjeshëm i legjislacionit vendor me kapitullin 24 të legjislacionit Evropian, përkatësisht nën-kapitullin për migrimin (lidhur me hyrjen dhe qëndrimin e të huajve në Republikën e Kosovës), si dhe zbatimi i saj.

Me qëllim të arritjes së objektivit strategjik janë paraparë objektiva specifike sipas modelit S.M.A.R.T të cilat janë në kohezion me vet qëllimin e politikës dhe rrjedhin si rezultat i analizës së situatës, përkatësisht defekteve të identifikuara në fushën e migrimit dhe të huajve. Në këtë kontekst synohet të adresohen çështjet si në vijim:

1) Fuqizimi i mekanizmit të kontrollit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave ligjore të Ligjit për të Huaj;
2) Avancimi dhe ndërlidhja e bazave të të dhënave dhe mbledhja e të dhënave të kompletuara për të gjitha kategoritë që mbulojnë fushën e të huajve (të gjitha kategoritë e leje-qëndrimeve, vizat, lejet e punës);
3) Rishikimi i procedurave me qëllim të forcimit të kritereve dhe rritjes së efikasitetit.

Këto objektiva janë paraparë në dokumentet planifikuese strategjike të Qeverisë së Republikës së Kosovës, respektivisht në Strategjinë Shtetërore për Migrim 2013-2018, si dhe në Strategjinë Shtetërore për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2013-2018. Objektivat e ngjashme janë të përfshira edhe në draft-Strategjinë Shtetërore për Migrim 2021-2025.

Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë

Qëllimi i politikës	Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)
Qëllimi: Zbatimi i obligimeve nga MSA në fushën e migrimit.	Programi Kombëtar për Zbatim të MSA-së
Objektivi strategjik: Harmonizimi i legjislacionit vendor me kapitullin 24 të legjislacionit Evropian, përkatësisht nën-kapitullin për migrimin (lidhur me hyrjen dhe qëndrimin e të huajve në Republikën e Kosovës), si dhe zbatimi i saj.	Strategjia për Migrim 2021-2025

Objektivat specifike: 1) Fuqizimi i mekanizmit të kontrollit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të dispozitave ligjore të Ligjit për të Huaj; 2) Avancimi dhe ndërlidhja e bazave të të dhënave dhe mbledhja e të dhënave të kompletuara për të gjitha kategoritë që mbulojnë fushën e të huajve (të gjitha kategoritë e leje-qëndrimeve, vizat, lejet e punës); 3) Rishikimi i procedurave me qëllim të forcimit të kritereve dhe rritjes së efikasitetit.	Sipas këtij koncept-dokumenti

KAPITULLI 3: OPSIONET

Duke u bazuar në identifikimin e problemeve, përfshirë shkaqet dhe pasojat, në kuadër të këtij Koncept Dokumenti janë trajtuar dhe elaboruar opsionet e ndryshme që synojnë adresimin e mangësive që janë identifikuar në analizën e situatës dhe me të cilat mund të procedohet në fushën e të huajve.

Rrjedhimisht, ky Koncept Dokument trajton tre (3) opsione kryesore:

1. Opsioni *status quo* (pa asnjë ndryshim) sipas të cilit situata aktuale, rrjedhimisht edhe problematikat që ekzistojnë do të vazhdojnë së ekzistuari;
2. Opsioni i dytë është opsioni me ndryshime për përmirësim të zbatimit të kornizës aktuale ligjore por pa ndryshime legjislative, i cili tenton të adresoj disa nga problematikat që janë identifikuar por e ka të pamundur të ofroj bazë të re ligjore, dhe
3. Opsioni i tretë është ai me ndryshime legjislative, konkretisht me hartim të ligjit të ri i cili parasheh adresimin e të gjitha problemeve të shtjelluara dhe përafrimin e legjislacionit vendor me *acqui* të BE-së.

Në këtë kuptim, analiza krahasimore mes tre (3) opsioneve të propozuara është elaboruar në Kapitullin 6 të këtij Koncept Dokumenti.

3.1: Opsioni *status quo* (pa asnjë ndryshim)

Opsioni i parë, pra opsioni *status quo* (pa asnjë ndryshim) parasheh vazhdimin e gjendjes aktuale në fushën e të huajve. Në këtë fushë, edhe përkundër arritjeve me plotësim-ndryshimin e Ligjit për të Huaj në vitin 2018, që kishte për qëllim kryesor harmonizimin me disa pjesë të legjislacionit Evropian, zbatimi i tij në praktikë nuk është në nivelin e duhur dhe ka shfaqur një numër të konsiderushëm të problemeve. Vazhdimi me opsionin pa ndryshim do të ndikoj që të vazhdohet me përballjen me sfidat aktuale që lidhen me kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të të huajve në territorin e Republikës së Kosovës.

Opsioni pa asnjë ndryshim do të sillte sfida të mëdha për akterët relevant të përfshirë në fushën e të huajve, ashtu siç janë identifikuar në Kapitulli 1 të këtij Koncept Dokumenti. Këto sfida, deri në një masë do të mund të sjellnin ngecje në zbatim të rekomandimeve dhe praktikave më të mira, dhe do të sjellnin efekt jo të kënaqshëm në zbatim të legjislacionit për të huajt në Republikën e Kosovës.

Në këtë kontekst, 'opsioni për asnjë ndryshim' nuk është një opsion i cili gëzon mbështetjen e akterëve institucional të përfshirë në fushën e të huajve. Gjithashtu, grupi punues ka shpreh qëndrimin se me përzgjedhjen e opsionit të parë nuk do të arrihet ndonjë progres në fushën e të huajve, pra do të vazhdonte gjendja aktuale në këtë fushë, andaj edhe ky propozim nuk gëzon mbështetjen e grupit punues.

3.2: Opsioni i përmirësimit të zbatimit të konrizës aktuale ligjore pa ndryshime legjislative

Opsioni i dytë shqyrton mundësinë e përmirësimit të zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime konkrete legjislative. Ky opsion, ngjashëm do të linte në fuqi ligjin aktual si shtyllë

bazike e fushës së të huajve, me disa ndryshime të vogla sistematike që synon përmirësimin e zbatimit të normave aktuale.

Siç është elaboruar edhe më lartë në kuadër të këtij Koncept Dokumenti, korniza ligjore që rregullon fushën e të huajve në Kosovë nuk është tërësisht e harmonizuar as me *acqui* të BE-së por edhe ka kundërthënje edhe me ligje dhe akte të tjera nënligjore. Për më tepër, nëse miratohet ky opsion, atëherë do të mund të arrihet në ngritje të kapaciteteve profesionale në fushën e zbatimit të legjislacionit për të huajt. Kjo nënkupton rritjen e numrit të të punësuarve sidomos në vendim-marrje. Opsioni për përmirësimin e zbatimit të kornizës aktuale ligjore pa ndryshime legjislative që e propozon ky koncept-dokument sygjeron një numër të masave në funksion të zbatimit të Ligjit për të Huaj dhe akteve tjera nënligjore dhe që ndërlidhen kryesisht me aktivitete si në vijim:

- Rritjen e kapaciteteve profesionale;
- Fuqizimin e kapaciteteve profesionale për të zbatuar Ligjin e plotësuar për të Huaj të vitit 2018;
- Digjitalizimin e shërbimeve me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe ndërlidhjen e bazave të ndryshme të të dhënave që do të rezultoj edhe me gjenerimin më të mirë të të dhënave statistikore me qëllim të hartimit të politikave në fushën që lidhet me të huajt.

Masat e propozuara me siguri që do kenë edhe implikime financiare, sidoqoftë kjo kosto do të mund të ekonomizohet me rritjen e numrit të të huajve me qëndrim të Republikës së Kosovës që do të kontribuonin në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Gjithsesi, duke vlerësuar se as ky opsion nuk do t'i shërbente si duhet përmirësimit të situatës dhe zbrazëtirave ligjore të identifikuara, andaj grupi punues nuk e rekomandon këtë opsion.

3.3: Opsioni i tretë, me ndryshime legjislative (I rekomanduar)

Opisioni i tretë shqyrton mundësinë e ndryshimeve ligjore përmes miratimit të një ligji të ri i cili do të rregulloj fushën e të huajve. Ky opsion nënkupton hartimin e një ligji të ri i cili do të rregullonte zbrazëtirat ligjore të hasura dhe do të rregullonte sfidat e reja të krijuara si rrjedhojë e zhvillimeve teknologjike të fundit. Kjo do të bëhej duke u bazuar në praktikat më të mira, si dhe në harmoni me *acqui* të Bashkimit Evropian.

Përkundër faktit se legjislacioni në fushën e migrimit, respektivisht për të huajt është ndryshuar në vitin 2018, duke qenë se lëvizjet e migrimit janë dinamike, ashtu dhe rregullativa ligjore në këtë fushë plotësohet vazhdimisht, si në nivel të BE-së ashtu edhe në nivel global. Në këtë drejtim, me qëllim të harmonizimit dhe përputhjes së legjislacionit vendor në fushën e migrimit me këto ndryshime, është e nevojshme që Ligji i plotësuar për të Huaj i vitit 2018 të miratohet si ligj i ri. Kjo edhe për shkak të rekomandimeve të dala nga 'Vlerësimi i boshllëqeve në fushën e migrimit' i vitit 2020, si dhe për të adresuar raportin me rekomandime nga Raporti Parlamentar i 24 qershorit të vitit 2019, lidhur me deportimin e disa shtetasve të huaj nga territori i Republikës së Kosovës. Në këtë frymë, grupi punues në konsultim edhe me akterët tjerë ka ardhur në përfundim që opsioni më i preferuar është hartimi i një Ligji të Ri për të Huajt.

Ky opsion shqyrton mundësinë e një miratimi të ligjit të ri për të huajt, me të cilin do të bëhej gjithashtu harmonizimi me ligjet tjera në fuqi që e rregullojnë fushën e të huajve brenda territorit të Republikës së Kosovës. Ky ligj do të hartohej mbi bazën e praktikave më të mira të vendeve tjera të rajonit si dhe vendeve të Bashkimit Evropian. Miratimi i opsionit të 3-të do të ofronte

rregullimin sa më të duhur e të drejtë të një fushe të rëndësisë se veçantë, siç është fusha e të huajve.

Miratimi i Ligjit të ri, ndër të tjera, do të bënte transpozimin e disa elementeve të Direktivës së Këshillit 2003/86/EC të 22 shtatorit 2003 për të drejtën e bashkimit familjar, të cilat për momentin nuk janë tërësisht të rregulluara me kornizën aktuale. Përmes kësaj do të përcaktohen një grup rregullash që përcaktojnë procedurën e shqyrtimit dhe trajtimit të kërkesave për bashkim familjar dhe për hyrje dhe qëndrim në territorin e Kosovës. Në këtë drejtim, procedurat do të jenë më efektive dhe të menaxhueshme, duke marrë në konsideratë edhe ngarkesën që ka administrata, dhe njëkohësisht ky ndryshim do të shërbente për të ofruar sigurinë e duhur ligjore për palët e interesit. Kjo pra, do të qartësonte procedurën dhe kriteret për të ushtruar të drejtën e bashkimit familjar nga shtetasit e huaj me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Kosovës.

Për momentin, korniza aktuale ligjore njeh disa kategori të lejeqëndrimeve, dhe atë si në vijim:

1. Lejeqëndimi i përkohshëm me qëllim të:

    1.1. ribashkimit familjar;
    1.2. autonom;
    1.3. arsimit parauniversitar ose arsimit të lartë;
    1.4. kërkime shkencore;
    1.5. arsye humanitare duke përfshirë refugjatët, personat nën mbrojtje plotësuese dhe viktimat e trafikimit me njerëz ose viktimave të kontrabandës me migrant dhe të huajt të cilët kanë shprehur vullnet të bashkëpunimit me autoritete kompetente;
    1.6. punës;
    1.7. punësimit të punëtorit të sistemuar, dhe
    1.8. qëllime tjera.

2. Lejeqëndrimi i përhershëm.

Janë identifikuar disa probleme që ndërlidhen me disa nga qëllimet për të cilat një person mund të marrë lejeqëndrim në Republikën e Kosovës. Fillimisht lejeqëndrimi i përkohshëm për arsye humanitare krijon paqartësi në zbatim, konkretisht në faktin se cilat kategori bien nën arsyet humanitare, dhe rrjedhimisht edhe në zbatim të tij. Vlerësohet se me miratim të ligjit të ri do të bëhej riformulimi i dispozitave që kanë të bëjnë me lëshimin e lejeqendrimit për raste humanitare, fillimisht duke krijuar një qartësi më të madhe se çka konsiderohet humanitare. Ligji aktual është i mangët, sepse ndonëse specifikon se cilat kategori gjithashtu gëzojnë të drejtën e lejeqëndrimit për arsye humanitare, përgjatë normave rregullon vetëm viktimat e trafikimit me njerëz, duke krijuar paqartësi për kategoritë e tjera. Gjithashtu me ligj të ri do të krijohej mundësia e shtimit të kategorive të reja që burojnë nga Ligji për Azil, e që nuk janë subjekt i rregullimit të këtij ligji, pra do të parashihej edhe marrja e lejeqëndrimit për personat me mbrojtje të përkohshme.

Ky ligj, në kuptim të përcaktimit të kategorive të lejeqëndrimit të përkohshëm do të bënte edhe dallimin mes lejeqëndrimeve për qëllime humanitare kundrejtë çështjes së urgjencave shëndetësore.

Gjithashtu, tek lejeqëndrimet e përkohshme kategoria e lejeqëndrimit për arsye të tjera sipas kornizës aktuale është disi e paqartë. Miratimi i opsionit me ndryshime legjislative do të krijonte mundësinë që kjo kategori të fitonte të drejtën në lejeqëndrim të përkohshëm përmes kërkesës së

institucioneve të Republikës së Kosovës. Pra, do të rregullohej mënyra e parashtrimit të kërkesës për arsyje të tjera nga institucioni relevant.

Në anën tjetër, lejeqëndrimi i përhershëm është një formë specifike e lejes së qëndrimit të ligjshëm brenda territorit të Republikës së Kosovës. Gjithsesi, ka raste të caktuara, personat që kanë një leje qëndrimi të përhershëm të Kosovës, gjithashtu kanë mundësinë që të posedojnë edhe një leje qëndrimi në një vend tjetër. Sipas normave në fuqi në ligjin aktual për të huajt, leja e qëndrimit e përhershme ka vlefshmëri të pakufizuar, gjithsesi e njëjta mund të revokohet për arsye specifike të caktuara. Megjithatë korniza aktuale ligjore nuk e parasheh mundësinë e revokimit të lejes së qëndrimit të përhershëm në rast se një i huaj ka apo merr një lejeqëndrim tjetër në një shtet tjetër. Ligji i ri në këtë drejtim do të parashikonte mundësine e revokimit dhe do të ishte në harmoni me direktivat relevante të BE-së.

Çka do të adresohet përmes ligjit të ri tek çështja e lejeqëndrimit të përhershëm është edhe ajo e testit të gjuhës. Direktivat e BE-së nuk parashohin që të ketë test për fitim të lejeqëndrimit të përherhshëm, mirëpo nuk kanë as dispozita që ndalojnë se një shtetas i huaj për të fituar lejeqëndrim të përhershëm, duhet të ketë një test të gjuhës. Andaj, përmes projekt ligjit të ri, Ministria e Punëve të Brendshme do të analizojë praktikat më të mira të vendeve të BE-së dhe do të trajtoj këtë çështje.

Tek pjesa e lejeqendrimeve, përmes ligjit të ri, gjithashtu do të rishikohet edhe afati i dhënies së lejeqëndrimit për të gjitha kategoritë, në atë mënyrë që të transpozojë afatet e vendosura në Direktivat relevante të BE-së. Është vlerësuar se afati për procedurën e leje qëndrimit ashtu siç është përcaktuar, është një afat relativisht i shkurtër. Duke marrë parasysh numrin e aplikacioneve për leje qëndrim, kryesisht për arsye të bashkimit familjar ose punësimit, afati i përcaktuar prej njëzetë (20) ditëve për procedurën e lëshimit të lejes së qëndrimit për të huajt dhe vërtetimit për lajmërimin e punës, nuk është i arsyeshëm. Në këtë drejtim rekomandohet të zgjatet afati në më së paku gjashtëdhjetë (60) ditë, si afat maksimal për lëshimin e vendimit. Gjatë kësaj kohe, do të lëshohet një leje provizore e cila do t'i shërbente të huajit për të vërtetuar se ka aplikuar për pajisje me lejeqëndrim.

Gjatë shqyrtimit të problemit gjithashtu është identifikuar se ekziston një kundërthënie në mes të Ligjit për të Huajt dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2019 për Integrimin e të Huajve. Kjo përplasje ekziston kryesisht në kompetencat që këto dy akte ligjore u japin institucioneve relevante. Për ta dhënë një udhëzim të qartë për kompetencat në lidhje me integrimin kulturor të një të huaji dhe për të harmonizuar Rregulloren Nr. 09/2019, ligji do të krijonte autorizime të qarta ligjore, dhe Rregullorja do të ndryshohet.

Në këtë drejtim është e dobishme që të pasqyrohet fryma e përgjithshme e nevojës për masa integruese, si dhe teste për integrim kulturor:

- Broshura LAMI e Këshillit të Evropës rreth testit të gjuhës për qasje, integrim dhe nënshtetësi[7].

[7] https://www.alte.org/LAMI-SIG

- KE së fundmi publikoi Planin e Veprimit për Integrim dhe Përfshirje (2021-2027) - integrimi në BE nuk është fushë tematike në vetvete, e mishëruar në direktivë ose rregullore, kompetencën ende e mbajnë Shtetet Anëtare: megjithatë nevoja për qasje të përbashkët është domosdoshmëri që kërkon miratimin e këtij mekanizmi[8] - fushat e ndërhyrjes: arsimi gjithëpërfshirës, promovimi i qasjes në shëndetësi, banimi i përshtatshëm dhe i përballueshëm, përmirësimi i mundësive të punësimit janë elemente të cilat do t'i përfshinin më mirë migruesit në shoqëri.

Sipas kornizës aktuale ligjore, por edhe në përputhje me Raportin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me ndriçimin e Rastit të Dëbimit të gjashtë Shtetasve Turq me datë 29 mars 2018, duhet adresuar edhe refuzimi apo revokimi i lejes së qëndrimit për rrethana të sigurisë shtetërore.

Refuzimi apo revokimi i lejes së qëndrimit për rrethana të sigurisë shtetërore ashtu siç është i rregulluar me Ligjin aktual për të Huajt, autorizon DSHAM-në që të revokojë ose refuzojë një kërkesë për leje qëndrim edhe në rastin e kërcënimit të sigurisë shtetërore (kontrolli i sigurisë në lidhje me rrethanat që lidhen me sigurim është nën Agjencinë e Inteligjencës së Kosovës), ku përmes dispozitave të ligjit në fuqi, përcaktohet përjashtimi i rregullit të përgjithshëm të përcaktuar në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative – pra përjashton kërkesën e këtij ligji për të specifikuar arsyet e marrjes së vendimit që mohon një të drejtë - kjo përfshinë organin kompetent që në raste të tilla leja e qëndrimit i revokohet një të huaji pa arsyetim në lidhje me rrethanat për të cilat është nxjerrë vendimi i tillë. Ky rregull vlen për të gjitha bazat ligjore të pranimit, përfshirë lejet për arsye humanitare. Në të vërtetë, rregullimi aktual i dëbimit të një të huaji me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Kosovës, pra të cilit i është lëshuar leja e qëndrimit (përfshirë arsyet humanitare), sipas Ligjit aktual për të Huajt në rast të ekzistencës së kërcënimit të sigurisë duhet të ndryshohet.

Me miratim të Opisionit të 3-të, veprimet procedurale do të ishin të qarta, procedurat do të ishin korrekte, dhe stafi që i përpunon aplikacionet do të kishte udhëzime të qarta, bazuar në ligj, për mënyrën e procesimit të vendimit. Nga ana tjetër, të drejtat e personit në fjalë, pra që i revokohet leja e qëndrimit për arsye të sigurisë shtetërore do të mbrohen nga arsye të mundshme arbitrare ose të pabazuara për vendim. Megjithatë, shteti ka të drejtë të dëbojë të huajt ose ta refuzojë kërkesën për qëndrim, por masat mbrojtëse procedurale duhet të respektohen.

Protokoli 7 i Këshillit të Evropës, neni 1 për masat mbrojtëse procedurale me raportin e tij shpjegues[9] përcakton në nenin 1 grupin minimal të masave mbrojtëse procedurale që duhet të përmbushen:

> *"1. Një i huaj që banon ligjërisht në territorin e një Shteti nuk dëbohet përveç në zbatim të një vendimi të marrë në përputhje me ligjin dhe atij i lejohet: ("a) që t'i parashtrojë arsyet kundër dëbimit, b) lënda e tij të rishqyrtoet, dhe c) të përfaqësohet për këto qëllime përpara autoritetit kompetent ose personit ose personave të caktuar nga ai autoritet.*

[8] https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/ip_20_2178
[9] https://rm.coe.int/16800c96fd

2. Një i huaj mund të dëbohet përpara ushtrimit të të drejtave të tij sipas paragrafit 1.a, b dhe c të këtij neni, kur dëbimi i tillë është i nevojshëm për interesat e rendit publik ose bazohet në arsye të sigurisë kombëtare”).

Për t’i asistuar shtetet për aplikimin e duhur të garancive në raste të ndryshme dhe komplekse, Këshilli i Evropës në prill 2020 publikoi Udhëzuesin për praktikën gjyqësore në lidhje me imigrim (dëbimi dhe Protokoli 7, neni 1, faqja 24)[10] dhe në gusht 2020 Udhëzuesin për nenin 8 të KEDNJ-së[11] (neni 8 i KEDNJ-së është gjithashtu një nga Direktivat themelore të Këshillit të BE-së 2003/86 KE të 22 shtatorit 2003 për të drejtën e bashkimit familjar)[12], praktika gjyqësore në këtë fushë, e cila është burim i së drejtës zakonore që përdoret kur ligji duhet të ndryshohet (shih çështjen *Ljatifi k. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë e 8 tetorit 2018*[13]). Burim shtesë i praktikës shtetërore në rast të shkeljes së masave mbrojtëse ndërkombëtare procedurale siç përcaktohet në nenin 13 të ICCPR mund të jetë shpjegimi shterues i analizës së rastit[14] E drejta ndërkombëtare dhe masat mbrojtëse procedurale në procedurat e dëbimit: Ahani k. Kanada). Rrjedhimisht, gjatë hartimit të Ligjit për të Huajt duhet t’i shtohet arsyetimi, të paktën në rast të ekzistencës së kërcënimit ndaj sigurisë.

Duke u bazuar në instrumentet ndërkombëtare relevante, por edhe në rekomandimet e raportit të komisionit parlamentar, me anë të ligjit të ri do të ndalohet dëbimi i të huajve para se të ushtrojnë të drejtën e tyre për ankesë kundër dëbimit të vet, tek një autoritet i pavarur.

Si çështje e përgjithshme në lidhje me masat mbrojtëse procedurale në rast të kërcënimeve ndaj sigurisë në lidhje me të drejtën e qëndrimit dhe dëbimit nga Kosova, rekomandohet që të miratohet një akt nënligjor i cili posaçërisht mbulon standardet procedurale që duhen respektuar gjatë procesit të vendimmarrjes (përfshirë të drejtën për dëgjim).

Gjithashtu me anë të ligjit të ri, do të qartësohej se kur duhet të jepet edhe masa e ndalimit të hyrjes në Republikën e Kosovës në rast të refuzimit dhe/ose revokimit të lejeqëndrimit. Sipas ligjit aktual në fuqi përcaktohet se mund të shqiptohet një masë e tillë me afat deri në pesë (5) vite, mirëpo nuk specifikon se mbi bazën e cilave kritere zyrtari përgjegjës përcakton afatin e vlefshmërisë së masës së ndalimit në hyrjen e territorit të Republikës së Kosovës. Me ligjin e ri do të përcaktohen disa rrethana rënduese mbi bazën e së cilave do të vendosej mbi shqiptimin e masës së ndalimit të hyrjes në Republikën e Kosovës, dhe kështu nuk do i lihej në tërësi në diskrecion zyrtarit.

Migrantët janë veçanërisht të cenueshëm ndaj privimit të lirisë. Shpeshherë migrantët e parregullt janë subjekt i dënimeve në Qendra të Mbajtes për arsye të kalimit të parregullt të kufrit shtetëror, kalim i kufirit me dokumente false, qëndrimi i jashtëligjshëm dhe të ngjashme.

---

[10] https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Immigration_ENG.pdf
[11] https://www.echr.coe.int/Documents/Guide_Art_8_ENG.pdf
[12] https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/ALL/?uri=CELEX%3A32003L0086
[13] https://hudoc.echr.coe.int/eng/#{"itemid":["001-182871"]}
14 E drejta ndërkombëtare dhe masat mbrojtëse procedurale në procedurat e dëbimit: Ahani k. Kanada [neni]

Republika e Kosovës e ka të themeluar Qendrën e Mbajtjes e cila vepron në kuadër të Ministrisë për Punë të Brendshme. Sipas situatës aktuale vendimi për ndalim në Qendër të Mbajtjes merret nga Policia Kufitare. Ky vendim nuk i nënshtrohet rishikimit nga organet e gjyqësorit, dhe migrantët si subjekt i këtij vendimi, mbahen deri në dymbëdhjetë (12) muaj në Qendër të Mbajtjes. Është diskutuar nga grupi që do të ishte e udhës që vendimi i organit kompetent, 72 orë nga nxjerrja e tij, t'i dërgohet për shqyrtim Gjykatës e cila do të vendosë në lidhje me rastin.

Nga ana tjetër, një numër i madh i shteteve tanimë bëjnë dallime në Qendër të Mbajtjes për Migrant, ku njihet edhe praktika e ndalimit administrativ për migrantët e parregullt në lidhje me shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve të migrimit, duke përfshirë qëndrimin pas skadimit të lejes, mosposedimin e identifikimit dokumente, duke përdorur dokumentet e udhëtimit të dikujt tjetër, duke mos u larguar nga vendi pasi ka kaluar afati i caktuar etj. Objektivi i ndalimit administrativ është që të garantojnë zbatimin proporcional dhe të drejtë të masave.

Përmes ligjit të ri do të forcohej bashkëpunimi ndërinstitucional, sidomos tek shkëmbimi i informatave. Sipas problemit të identifikuar që Sistemi Informativ i Vizave i Kosovës (SIVK) nuk ndërlidhet automatikisht me bazën e të dhënave të DSHAM-së për të huajt. Mangësi të ngjashme raportohen në lidhje me ndërlidhjen në mes të bazës së të dhënave të DSHAM-së dhe bazave të të dhënave tjera si ato nga Policia e Kosovës, Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregëtisë (ARBK), Agjencia e Regjistrimit Civil dhe institucioneve të tjera relevante. Andaj, ligji i ri do të krijonte një bazë të mirëfilltë ligjore për shkëmbim dhe ndërlidhje të këtyre bazave, në mes të institucioneve relevante duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtje të të dhënave personale.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Ndikimet e pritshme janë identifikuar dhe elaboruar në kuadër të këtij Kapitulli, duke u bazuar në opsionin i cili ka gjetur mbështetje nga grupi punues, përkatësisht opsioni i ligjit të ri të Ligjit për të Huaj.

Një elaborim më i detajuar i ndikimeve të mundshme përkitazi me opsionin e propozuar në këtë Koncept Dokument është paraqitur në vijim:

4.1. Identifikimi i ndikimeve ekonomike:

Duke ndjekur globalizimin, migrimi u shndërrua në një fenomen global ku asnjë Shtet nuk është lënë pas.
Për të gjitha shtetet, politika e imigrimit dhe emigrimit paraqet një nga fushat më të shenjta të juridiksionit kombëtar. Kur rregullohet qeverisja dhe menaxhimi i migrimit, sovraniteti i shtetit është i kufizuar nga detyrimet e shtetit që burojnë nga traktatet dhe marrëveshjet e detyrueshme ndërkombëtare, të lidhura me shtete të tjera ose organizata ndërkombëtare, si dhe e drejta ndërkombëtare zakonore.

Migrimi ka ndikim në fusha të ndryshme të politikave, por mbi të gjitha në politikat ekonomike me tregun e punës, punësimin, politikën demografike, integrimin, politikat sociale dhe shëndetësore, politikën e arsimit, sigurinë, mbrojtjen.
Mirëpo, shtetet që artikulojnë interesin e tyre kombëtar duke adoptuar strategji kombëtare për migrimin, përpiqen të përmbushin dy synime kryesore:
1) të ruajnë identitetin kombëtar në përputhje me standardet ndërkombëtare;
2) të sigurojnë prosperitet ekonomik për popullsinë e përgjithshme.

Kosova nuk përbën përjashtim, shteti ka adoptuar Strategjinë Shtetërore për Migrimin 2019-2023, e cila është subjekt i ndryshimeve. Plani i Veprimit si instrument ekzekutiv, rendit mënyrat dhe masat konkrete për të përmbushur objektivat, të cilat në radhë të parë kanë për qëllim kontrollin mbi lëvizjet e rregullta, si dhe të parregullta.

Korniza normative e Kosovës, në radhë të parë Ligji për të Huajt që u ndryshua herën e fundit në mars 2018, plotëson në përgjithësi kushtet e përcaktuara kryesisht në kornizën e BE-së për migrimin, për këtë qëllim, ndryshimi nga viti 2018 është ai që do të duhej të ketë ndikimin më të drejtpërdrejtë ekonomik, drejt proceseve më të shpejta ekonomike duke kontribuuar në tatimet dhe rritjen e qëndrueshme ekonomike në nivelin lokal ose shtetëror. Bashkimi i dy vendimeve të përveçme administrative, si BlueCard në BE për punëtorët e kualifikuar, (i pari: leja e qëndrimit, i dyti: leja e punës për aplikuesit që dëshirojnë të pranohen për qëllime pune), do të duhej të çojë në përpunimin më të shpejtë të aplikacioneve, nën një autoritet (DSHAM - Ministria e Punëve të Brendshme).

Duke qenë se stafi i DSHAM-së nuk është trajnuar mjaftueshëm - Akti nuk përmban asnjë normë që do të kërkonte nga Autoriteti Shtetëror dhe punonjësit për të ofruar trajnim profesional mbi risitë e prezantuara nga akti, rezultati i një praktike të tillë mund të mos përmbushë rezultatet e pritura.

Imigrantët kontribuojnë në rritjen ekonomike. Sipas Debateve të Politikës së Migrimit të OECD-së [15]nga maji 2014, "imigrantët përfaqësuan 47% të rritjes së fuqisë punëtore në SHBA, dhe 70% në BE për një periudhë dhjetëvjeçare - megjithëse vetëm një pjesë e vogël e tyre arriti përmes migrimit të menaxhuar të punës, dhe pjesa më e madhe arriti nëpërmjet kanaleve tjera: familja, lëvizjet humanitare dhe të lira", dhe është e qartë se ata kontribuojnë në rritjen ekonomike, por kjo është në rastin e vendeve me zhvillim të mirë të ndërtimit të kapaciteteve, si sistem mbështetës për integrimin e shpejtë të imigrantëve në shoqërinë pritëse.

Rritja ekonomike e Kosovës, para pandemisë së COVID-19, ishte një rritje e qëndrueshme ekonomike. Ndryshimet e Ligjit për të Huajt, *ndër të tjera*, parashohin një nga masat për të mbështetur reformat ekonomike dhe strukturore të vendit duke ofruar një sistem të përpunimit të shpejtë të kërkesave për pranimin e të huajve në tregun e punës. Një fuqi punëtore e kualifikuar, nëse jo vendore, atëherë fuqi punëtore e huaj, është një nga kushtet për të përmbushur konkurrueshmërinë ekonomike. Numri i lejeve të qëndrimit të përkohshëm për punësim [16](në 2017: 2865, në 2018: 2809, në 2019: 2473) tregojnë, se pranimi i të huajve në Kosovë është proces në zhvillim e sipër, që kërkon monitorim të vazhdueshëm, veçanërisht në rrethanat pas COVID-19 kur ekonomia pritet të marrë hov përsëri.

Masat e propozuara në koncept dokument:

1. ndërtimi i kapaciteteve për zhvillimin e kurrikulës për trajnimin në shërbim për migrimin (me mundësinë e kurrikulës për komunitetin akademik) - për stafin e të gjitha agjencive të përfshira në procedurat lidhur me migrimin (duke përfshirë Policinë, Shërbimin Konsullor, Regjistrin Civil...) do të ofrojë njohuritë profesionale që do të kontribuojnë në përpunimin e rregullt të aplikacioneve, si dhe në propozimet e dokumentuara mirë dhe të bazuara në evidenca përkitazi me ndryshimet e nevojshme të strategjisë ose legjislacionit të migrimit. Gjithashtu, kjo do të ketë ndikim të drejtpërdrejtë në qeverisjen dhe sundimin e ligjit, pra në mjedisin që është parakusht për investime afatgjata në ekonominë kombëtare.

2. ndërtimi i kapaciteteve për statistikat e migrimit - do të ofrojë mjetet themelore për të kuantifikuar dhe kualifikuar trendet përkitazi me pranimin e të huajve, megjithatë, për të kontribuuar gjithashtu në shifra më të mira të migrimit neto, pra një tregues me rëndësi për ekonominë e vendit.

3. zhvillimi i regjistrit elektronik të popullsisë - si një masë - në sinergji me reformat e tjera, veçanërisht reformën e administratës publike - do të kontribuonte në shërbime më të mira të përgjithshme të qeverisë në nivelin qendror, si dhe në atë lokal - dhe do të kontribuonte në rolin e DSHAM-së për të kontrolluar ligjshmërinë e lëvizjes brenda vendit - duke ulur në këtë mënyrë edhe anomalitë në lidhje me të drejtat ligjore të qëndrimit në një adresë të caktuar. *Status quo*-ja e situatës aktuale ka rëndësi thelbësore për të prezantuar reforma edhe në këtë fushë, edhe për qëllimet e detyrimeve tatimore me vend.

---

[15] https://www.oecd.org/migration/OECD%20Migration%20Policy%20Debates%20Numero%202.pdf
[16] Republika e Kosovës, Profili i Lehtë i Migrimit 2019 – Autoriteti Qeveritar për Migrim

4. futja e sistemit të menaxhimit të rasteve, së bashku me masat e tjera të propozuara, do të mundësojë sistemin e gjurmimit të shpejtë edhe në këtë fushë, dhe do të ekonomizojë kohën, si dhe funksionalizimin e punës në DSHAM, deri në masën që të shndërrohet në një shërbim modern në përputhje me tendencat e digjitalizimit dhe interoperabilitetin e nevojshëm (horizontal dhe vertikal). Shërbimi më i shpejtë i kryer nga një staf profesional, duke bërë krahasimin e praktikës së shteteve të tjera që kanë futur një sistem të tillë, do të jetë me përfitim edhe për zhvillimin më të shpejtë ekonomik të vendit.

5. ndryshimi i Ligjit për të Huajt me masa mbrojtëse procedurale në rastet e dëbimit të të huajve është çështje e sundimit të ligjit, dhe së këndejmi ka ndikim të drejtpërdrejtë në ndikimin e përgjithshëm të Republikës së Kosovës në fushën e qeverisjes së mirë dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.

6. masat e zhvilluara mirë për integrimin e të huajve në shoqërinë vendore janë një investim në shoqëri, që rrjedhimisht kontribuon në integrimin më të mirë ekonomik të një të huaji në tregun e punës: propozimi për të eliminuar kundërthëniet ligjore në Ligjin për të Huajt në lidhje me përgjegjësinë për integrimin kulturor të të huajve do të ofrojë kushte transparente, të cilat nuk do të paraqiten si pengesë për marrjen e lejes së qëndrimit.

Zhvillimi i kapacitetit të njohurive mbi migrimin në Ministrinë e Punëve të Brendshme, DSHAM, duke futur trajnimin profesional multidisiplinar në fushën e migrimit, shoqëruar me prezantimin e menaxhimit të rasteve të aplikimeve për pranim do të jetë një aset për administratën publike - do të zvogëlojë pengesat burokratike, gjë që do të demonstrojë potencial të lartë ekonomik. Integrimi ekonomik i të huajve do të ketë ndikim pozitiv në krijimin e vendeve të reja të punës për të rinjtë dhe gjithashtu do të ketë ndikim pozitiv në rritjen e tatimeve.

4.2. Identifikimi i ndikimeve shoqërore

